



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HAS

Nr. _____ prot.

Krume, më 11.08.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës- PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Rikonstruksion i shkolles 9-vjeçare "Sejdi Dida", Krumë”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

VLERA E FONDIT LIMIT: 125,968,569.17 (njqind e njezete e pese milion e nenteqind e gjashtedhjetë e tete mije e peseqind e gjashtedhjetë e nente pike shtatembedhjetë) Leke pa TVSH.

Argumentimi: Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Has ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit (Shtojcat).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar dhe kërkohej një operator ekonomik i cili të ketë minimumin e kërkuar duke marrë në konsideratë objektin e kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës **31 mars të vitit pasardhës**, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2 Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në neni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.3 Operatorët Ekonomikë ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet për vitin 2024 dhe keqet e maturuara për vitin 2025.

Shenim: Kjo kërkesë përmbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, nën 3.1/a, b, c dhe nën 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

Pagesa e taksave është një detyrim ligjor dhe meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

- Për kontrata të realizuara me autoritete publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e vlerësimit;
2. Kontratën/Kontratën;
3. Situacionin përfundimtar;
4. Akt Kolaudimi
5. Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore;
6. Çertifikatën e marrjes në dorezim/ Çertifikatën e perhershme të marrjes në dorezim

-Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kontratë sipërmarrje;
2. Leje për kryerje punimesh
3. Situacionin përfundimtar;
4. Fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore;
5. Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e perhershme të marrjes në dorezim;

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Shenim: Per punet e ngjashme te realizuara si BOE krahas dokumenteve te mesiperme duhet te paraqitet edhe kontrata e bashkepunimit ku percaktohet ndarja e zerave te punimeve ndermjet paleve, ndersa per punet e ngjashme te realizuara si nenkontraktor duhet te paraqitet kontrata e nenkontraktimit ku percaktohen zerat e punimeve si dhe miratimi i autoritetit kontraktor/investitorit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Përvoja e mëparshme është element shumë i rëndësishëm që garanton autoritetin kontraktor, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses.

2.3.2 Operatorët Ekonomike duhet të dëshmojnë se disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe për kategorite e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42, date 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

- NP- 1 A** Punime gjurmimi në tokë.
- NP- 3 D** Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada
- NP- 12 A** Punime të inxhinierisë mjedisore

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

- NS- 1 A** Punime për prishjen e ndërtimeve
- NS- 2 A** Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.
- NS- 4 A** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.
- NS- 12 A** Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.
- NS- 14 A** Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.
- NS- 18 A** Punime topogjeodezike.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktura dhe Energji, (ose Ministrise kompetente te kohes) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton *“Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në pdrputhje me standartet kombëtare ose europiane.”*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve ne preventivin e hartuar nga projektuesi pasi aktivitetet kryesore qe do te beje Kontraktori per perfundimin me sukses te punimeve sipas kontrates ne kete objekt jane:

- Mobilizimi
- Furnizimi, Transporti dhe Magazinimi i Materialeve
- Aktivitetet e Punimeve Ndertimore
- Mbrojtja e Punimeve, ambientit dhe publikut
- Kontrolli laboratorik, Testimi dhe Kontrolli i cilesise se materialeve

Klasat janë përcaktuar referuar Lidhjes 4, të VKM 42/2008, në proporcion me preventivin e punimeve dhe fondin limit dhe jane analizuar ne tabelen e meposhteme:

Kategoria e Licenses	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Vlera e punimeve në preventiv, sipas kategorisë përkatëse
NP-1 A Punime gërmimi në tokë.	Ne preventivin e punimeve parashikohen punime per Germim dheu me krahe e transport me karroce dore, deri ne 10m, kategoria III; Germim dheu me ekskavator me goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke e zakonshme, kategoria III, me shkarkim ne toke, Germim e mbushje dheu me krah per kanale kategori III, h=1.5m, Germim per	252,199.42

	mbushje dheu per kanalet dhe gropat e elektrodave.	
NP-3 D Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada	Ne Preventivin e punimeve Parashikohen punime per 1. Prishjen dhe pastrimin, 2. Punime Hidroizolimi dhe Shtresash, 3. Punime per vendosje dyer dhe dritare, 4. Kanalizimet e brendshme dhe te jashtme, 5. Punime elektrike, 6. Ndricimi i jashtem, 7. Instalimet e rrymave te dobeta, 8. Instalimet e rrufepritesit, 9. Makineri dhe pajisje kondicionimi HVAC, 10. Instalimet e sistemit te ajerit per ventilimin dhe rrjeti i shperndarjes se tubave, 11. Sistemi I ngrohjes me Kaldaj, 12. Radiatoret, 13. Pompat,ene zgjerimi,ndares hidraulik. Etj.	125,968,569.17
NP-12 A Punime të inxhinierisë mjedisore	Zbatuesi i Punimeve eshte ngarkuar me detyrime te përgjithshme ne kujdesin per mjedisin. <i>Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose rristurime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor,</i> dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik.	231,630
NS-1 A Punime për prishjen e ndërtimeve	Ne preventivin e punimeve parashikohen Prishje mur tulle me pastrim, per hapje dyersh ose dritare te reja; Prishje shtresa betoni, ne dysHEME; Prishje suvatim i jashtem; Prishje suvatim muri i brendshem; Prishje suvatim solete; Prishja e rrjetit ekzistues elektrike; Prishja e rrjetit ekzistues hidraulik; etj.	7,394,878.29
NS-2 A Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.	Ne preventivin e punimeve parashikohen punime per Kanalizimet nga pajisjet sanitare deri tek shakarkimi ne puseta etj.	2,537,536.8
NS-4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës	Ne preventivin e punimeve parashikohen punime tavani dhe suvatimi, punime bojatisje, punime murature tulle, punime dyer dritare, punime hidroizolimi dhe çatite, nenshtresa dhe shtresa ne territorin e ndertesave etj.	24,833,093.46

teknike ndërtuese.		
NS- 12 A Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.	Ne preventivin e punimeve parashikohen punime per Instalimet e sistemit te ajerit per ventilimin dhe rrjeti i shperndarjes se tubave; Rjeti i tubave te bakrit UNI EN 1057 etj.	2,178,307.01
NS-14 A Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.	Ne preventivin e punimeve parashikohen punime per instalime elektrike si F.V.Kuti per çelsa e prize; Kuti PVC; Celes me 1 pulle me kuti jashte murit 10A, 250V; etj.	7,609,550.68
NS-18 A Punime topogjeodezike	Zbatuesi i punimeve eshte i ngarkuar per kryerjen e punimeve per pike timin e gjurmes se objektit dhe nxjerrjen e kuotave. Konsiderohet zbatimi i rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh. Theksojme se Punimet topogjeodezike do të mbështeten në shkallën e plotë të përgatitjes profesionale, në përdorimin e teknologjive bashkëkohore për matjet fushore dhe përpunimin kompjuterik të të dhënave, për të plotësuar kërkesat teknike të parashtruara nga projektuesit. Sa i perket klases "A" se kerkuar, theksojme se kjo fushe specifike nuk shprehet ne zera konkret te preventivit, por eshte komplekse dhe gjithëpërshiresë ne te gjitha fazat e zbatimit te projektit, nga momenti i marrjes ne dorezim te sheshit te ndertimit deri ne perfundimin e punimeve dhe dorezimin prane AK-se, te sheshit te ndertimit	0-20,000,000 leke

2.3.3 Operatoret Ekonomike duhet të kenë një punësim mesatar të paktën 50 (Pesdhjete) personave të siguruar për periudhën **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave.

Për këtë ofertuesi duhet të paraqesë:

- a)** Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin nga muajt e kerkuar;
- b)** Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet

te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur ne bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit të mesiperm për numrin minimal të punonjësve duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t’i referohemi projektit, preventivit, raportit teknik, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi	1 (nje)
- Inxhinier Ndërtimi profili Strukturist	1 (nje)
- Inxhinier Ndërtimi profili Gjeoteknik	1 (nje)
- Inxhinier Elektrik	1 (nje)
- Inxhinier Hidroteknik	1 (nje)
- Inxhinier Mekanik	1 (nje)
- Inxhinier Elektronik	1 (nje)
- Inxhinier Mjedisi	1 (nje)
- Inxhinier Gjeodet/Topograf/Gjeomatik	1 (nje)
- Arkitekt	1 (nje)

-Për stafin e mësipërm operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë: Kontratë pune e vlefshme, Diplome, CV si dhe të figurojnë në listepagesat e operatorit ekonomik minimalisht për periudhën **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave.

Shenim: Kjo kërkesë përmbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhes të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet

të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimimit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i dryshuar, si dhe ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, dhe me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Referuar natyrës dhe objektit të kontratës së prokurimit, shfaqet e nevojshme disponimi i stafit në nivel inxhinieri për realizimin e ketyre punimeve. Kriteri i mësipërm në lidhje me stafin kryesor është lidhur edhe me disponueshmërinë e licencës dhe kriterëve të licencës së kërkuar. Konkretisht në Vendimin 42, datë 16.01.2008 i Këshillit të Ministrave “*Per miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*”, i ndryshuar parashikohet se: “*Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar, sipas: I. Kategorive të punimeve të zbatimit duke u mbështetur në: - profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë.*”

Sa më sipër, duke marrë parasysh natyrën e punëve të objektit të prokurimit, ka perzgjedhur stafin e drejtuesve teknik, të cilët janë të nevojshëm për realizimin e punimeve. Për më tepër duke qenë se këto punime janë të një rëndësie të vecantë dhe në të njëjtën kohë konsistojnë në rikonstruksion dhe shtesë objekti i një shkolle 9 vjeçare me standarte europiane vlerësohet e nevojshme që të kerkohen specialist të fushave inxhinierike si: Inxhinier Ndërtimi profili strukturist, profili gjeoteknik, Inxhinier Elektrik, Inxhinier Hidroteknik, Inxhinier Mekanik, Inxhinier Elektronik, Inxhinier Mjedisi, Inxhinier Gjeodet/Topograf/Gjeomatik, dhe Arkitekt.

Në lidhje me kërkesën e Drejtuesit Teknik Inxhinier Ndërtimi, njesia e prokurimit ka marrë në konsideratë se projekti për rikonstruksionin e shkolles përfshin punime civile industriale dhe ka si qëllim kryesor që të sigurojë ambiente sipas standarteve europiane në fushën e arsimit dhe përfshin kryesisht punime ndërtimi.

Në lidhje me kërkesën e Drejtuesit Teknik Inxhinier Elektrik njesia e prokurimit mbanë në konsideratë se projekti për rikonstruksionin e shkolles përfshin punime elektrike në një sasi të konsiderueshme referuar projektit elektrik dhe është e nevojshme që këto punime të kryhen nën kujdesin e Inxhinierit Elektrik

Në lidhje me kërkesën e Drejtuesit Teknik Inxhinier Hidroteknik njesia e prokurimit mbanë në konsideratë se projekti për rikonstruksionin e shkolles përfshin punime hidraulike dhe sisteme të kalanzimeve përreth objektit dhe është e nevojshme që këto punime të kryhen nën kujdesin e Inxhinierit Hidroteknik.

Në lidhje me kërkesën e Drejtuesit Teknik Inxhinier Mekanik njesia e prokurimit mbanë në konsideratë se projekti për rikonstruksionin e shkolles përfshin punime mekanike ku përfshihen

instalimet e ngrohjes dhe ftohjes dhe instalimet e pajisjeve të kondicionimit dhe është e nevojshme që këto punime të kryhen nën kujdesin e Inxhinierit Mekanik.

Në lidhje me kërkesën e Drejtuesit Teknik Inxhinier Elektronik, njësia e prokurimit mbanë në konsideratë se projekti për rikonstruksionin e shkollës përfshin punime elektronike. Pajisje e jashtme VRF, 48.0 kW Ftohje, 48.0 kW Ngrohje, Seria YKD, Dim 1650x1220x740 mm, F.V Njësi e brendshme VRF kasete 4-rruge 90x90 cm, Fuqi Ftohje 7.1 kW dhe në Ngrohje 8.0kW; R32-R410A Dim: 258x950x950 mm etj. dhe është e nevojshme që këto punime të kryhen nën kujdesin e Inxhinierit Elektronik.

Në lidhje me kërkesën e Drejtuesit Teknik inxhinier Mjedis, Njësia e prokurimit ka marrë në konsideratë dhe thekson se referuar raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, raportit teknik dhe Specifikimeve teknike të projektit objekt prokurimi, si dhe kompleksitetit të kontratës, Zbatuesi i Punimeve është ngarkuar me detyrimet të përgjithshme në kujdesin për mjedisin. Metodat e punës që duhet të aplikohen nga zbatuesi duhet të synojnë në minimizimin ose nëse është e mundur në ndalimin e cenimeve ndaj mjedisit. Gjithashtu kërkohej që të ndermerren me regorizitet masa mbrojtëse sa herë që të jete e nevojshme për të minimizuar ose për të ndaluar efektin negativ në mjedis.

Rikonstruksioni i objektit ka si impakti potencial ndotjen e ujërave sipërfaqesore si rezultat i germimeve, mbetjet, baltat e gjeneruar nga përdorimi i makinerive të renda ose shkarkimi aksidental i lubrifikateve, solventeve, bojërave dhe vajërave.

Ndotjet aksidentale të ujërave sipërfaqesore e nëntokësore, mund të ndiqen nga pasojat në shëndet etj. Këto pasojat mund të vijnë si rezultat i gjermimeve. Për të parandaluar ndotjet aksidentale, apo evituar pasojat e tyre, vëmendje e veçantë do të kushtohet respektimit të rregullave teknike dhe aplikimit të eksperiencave me të mira inxhinierike.

Sa me sipër Njësia e Prokurimit vlerëson se gjatë zbatimit të punimeve është e nevojshme që këto punime të kryhen nën kujdesin e Inxhinierit.

Në lidhje me kërkesën e Drejtuesit Teknik Inxhinier Gjeodet/Topograf/Gjeomatik njësia e prokurimit mbanë në konsideratë se zbatuesi i punimeve është i ngarkuar për kryerjen e punimeve për piketimin dhe nxjerrjen e kuotave. Njësia e prokurimit thekson se punimet topogjeodezike do të mbështeten në shkallën e plotë të përgatitjes profesionale, në përdorimin e teknologjive bashkëkohore për matjet fushore dhe përpunimin kompjuterik të të dhënave, për të plotësuar kërkesat teknike të parashtruara nga projektuesit dhe është e nevojshme që këto punime të kryhen nën kujdesin e Inxhinierit Gjeodet/Topograf/Gjeomatik.

Në lidhje me kërkesën e Drejtuesit Teknik Arkitekt njësia e prokurimit mbanë në konsideratë se projekti për rikonstruksionin e shkollës përfshin punime për zbatimin e projektit arkitektonik dhe ndjekjen e mobilimit të shkollës dhe është e nevojshme që këto punime të kryhen nën kujdesin e Arkitektit.

Sa me sipër analiza e këtyre të dhënave dhe kontrolli i nevojshëm në të gjithë etapën e punës që kërkohej të realizohet, kërkon minimalisht inxhinieret e kërkuar.

2.3.5 Krahas stafit teknik Operatoret Ekonomike duhet të kene të punesuar staf mbeshtetes si me poshte:

Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, diplome/deshmi përkatëse leshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriat Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave, si më poshtë:

Teknik Ndertimi	1 (nje)	Diplome shkolles mesme
- Teknik Mekanik	1 (nje)	Diplome shkolles mesme
- Teknik Elektronik	1 (nje)	Diplome shkolles mesme
- Teknik Gjeometer/Topograf	1 (nje)	Diplome shkolles mesme
- Elektracist	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Hidraulik	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Hekurkthyes	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Betonues	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Suvatues/murator	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Pllakashtues	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Bojaxhi	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Hidroizolues	1 (nje)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Punonjes Gipsi	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Punonjes Fasade	1 (nje)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Saldator	1 (nje)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Specialist Dur Alumini	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Specialist kondicionimi	1 (nje)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Specialist IT	1 (nje)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Marangoz	1 (nje)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Shofer	2 (dy)	Leje Drejtimi
- Manovrator	2 (dy)	Deshmi e Aftesise Profesionale (nga DPSHTRR)
- Automakinist	1 (nje)	Deshmi e Aftesise Profesionale (nga DPSHTRR)

Operatori ekonomik duhet të paraqese për stafin e mesiperm: Kontratat individuale të punës, Diplome Universitare/ Diplome e shkolles mesme/ Deshmite profesionale/ Deshmi e Aftesise Profesionale (DAP)/ Leje Drejtimi nga DPSHTRR sipas shenimeve për çdo kategori të mesiperme si dhe stafi i mesiperm të figuroje në listepagesat e shoqërise për të pakten muajin e fundit të deklarimit.

V.O- Dokumentacioni (Diplomat/deshmite/çertifikatat) duhet të jenë të leshuara sipas legjislacionit përkatës të arsimit profesional.

Për profesionet si me sipër, operatori ekonomik duhet të plotësoje tabelën si me poshtë:

Nr.	Emer Mbiemer i punonjesit	Profesioni i punojesis ne certifikate / diplome	Emri i Institucioni publik/privat leshues i certifikates/diplomes	Numri indetifikues i certefikates/diplomes	Nr NIPT - (Ne rast se leshuesi është institucion privat)
1					

2					
....					

Shenim: Kjo kërkesë përmbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhes të vetedeklarimit sipas shtojces përkatëse të DST-se dhe tabelës së mësipërme, të cilat duhet të dorëzohen në fazën e ofertimit në SPE. Ndërsa dokumentacioni provues i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe fillimit të afatëve të ankimit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ligjin nr. 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” datë 10.09.1998” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Për stafin mbështetës, në lidhje me kualifikimet janë parashikuar nivele si Diplome e shkollës mesme/ Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/ Leje Drejtimi /Deshmi e Aftësisë Profesionale etj, të cilat janë dokumente zyrtare të llojeve të ndryshme, të lëshuara nga institucione shtetërore, të cilat regjistrojnë arritjet e një individi pas vlerësimit, sipas një procedure e standardi të paracaktuar.

Po ashtu profilet e kërkuar dhe numri i tyre, janë kërkuar në proporcion me natyrën dhe volumin e procedurës së prokurimit, duke marrë në konsideratë edhe zërat konkretë të preventivit të zbatimit të punimeve, volumnit të tyre, Raportit Teknik dhe Specifikimet Teknike, si dhe mjeteve që duhet të jenë në dispozicion, pasi parashikohen punime të natyrës për 1. Prishjen dhe pastrimin, 2. Punime Hidroizolimi dhe Shtresash, 3. Punime për vendosje dyer dhe dritare, 4. Kanalizimet e brendshme dhe të jashtme, 5. Punime elektrike, 6. Ndricimi i jashtëm, 7. Instalimet e rrymave të dobëta, 8. Instalimet e rrufepritesit, 9. Makineri dhe pajisje kondicionimi HVAC, 10. Instalimet e sistemit të ajrit për ventilimin dhe rrjetit të shpërndarjes së tubave, 11. Sistemi i ngrohjes me Kaldaj, 12. Radiatorët, 13. Pompat, enë zgjerimi, ndares hidraulik. etj. të ndryshme, Elektrike dhe Sinjalistika, transport materiale ndërtimi dhe germim themelesh.

Njesia e Prokurimit thekson se punimet konsistojnë në rikonstruksionin shkollës 9 vjeçare e cila do të ketë nevojë për kryerjen e punimeve nga stafi mbështetës i kërkuar, kjo bazuar edhe në zërat e preventivit të hartuar nga projektuesi.

Po ashtu, Njesia e Prokurimit thekson se duke marrë në konsideratë mjetet minimale të nevojshme për kryerjen e punimeve është përlogaritur edhe numri i shofereve dhe manovratoreve që duhen.

Sa më sipër me qëllim realizimin e punimeve në përputhje me specifikimet teknike dhe zbatimin me sukses të kontratës si dhe kontrollin e nevojshëm në të gjithë etapat e punës që kërkohet të realizohet, kërkon minimalisht stafin e kërkuar.

Referuar natyrës, dhe përmasave/ volumnit të punimeve që përmban objekti i prokurimit, **me qëllim vërtetimin e aftësisë zbatuese të kontratës**, njësia e prokurimit vlerëson se, operatorët ekonomik

duhet të disponojnë stafin mbështetës të kualifikuar për kryerjen e të gjitha punimeve objekt prokurimi, të cilët duhet të jenë me specialitetin: **Teknik ndërtimi, teknik mekanik, teknik elektronik, Teknik Gjeometer/Topograf, hidraulike, elektrikist, hekurkthyes, betonues, saldator, bojaxhi, suvatues / murator, pllakashtrues, hidroizolues, punonjes gipsi, punonjes fasade, specialist dur alumini, specialist kondicionimi, specialist IT, marangoz, shofer, manovrator, automakinist** pasi pa këto punonjës nuk mund të kryhen/ realizohen punimet objekt kontrate prokurimi.

Jane kërkuar punonjes të specializuar dhe të certifikuar me qëllim ndërtimin e investimit tejet të rëndësishëm sipas projektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, dhe **vërtetimin e aftësisë organizative, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën.**

Teknike ndertimi, i cili është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndertimit, sipas zërave të preventivit të punimeve, duke patur parasysh punime ndertimore që do të kryhen si: betone etj.

Teknike mekanik, i cili është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve te ndertimit, me fokus te vecante makinerite dhe pajisjet qe do te operojne ne objekt etj.

Teknike elektronik, i cili është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të FV Paisje e jashtme VRF ,48.0 kW Ftohje,48.0 kW Ngrohje,Seria YKD,Dim 1650x1220x740 mm, F.V Njesi e brendshme VRF kasete 4-rruge 90x90 cm,Fuqi Ftohje 7.1 kW dhe ne Ngrohje 8.0kW;R32-R410A Dim:258x950x950 mm etj. dhe është e nevojshme qe keto punime te kryhen nga teknik elektronik nen kujdesin e Inxhinierit Elektronik.

Teknike Gjeometer/Topograf, i cili është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve topogjeodezike do të mbështeten në shkallën e plotë të përgatitjes profesionale, në përdorimin e teknologjive bashkëkohore për matjet fushore dhe përpunimin kompjuterik të të dhënave, për të plotësuar kërkesat teknike të parashtruara nga projektuesit dhe është e nevojshme qe keto punime te kryhen nga teknik gjeometer/topograf nen kujdesin e Inxhinierit Gjeodet/Topograf/Gjeomatik.

Janë kërkuar **elektriciste**, të cilet janë të nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e instalimeve elektrike, sipas zërave të preventivit të punimeve.

Janë kërkuar **Hidraulike**, të cilet siç parashtruam me lart janë të nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e instalimeve hidraulike për realizimin e furnizimit me uje, sipas zërave të preventivit të punimeve.

Janë kërkuar **hekurkthyes**, të cilet janë të nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e konstruksioneve metalike dhe kanalinave metalike, sipas zërave të preventivit të punimeve.

Janë kërkuar **betonues**, të cilet janë të nevojshëm për realizimin e punimeve të hedhjes se betonit ne veper, sipas zërave të preventivit të punimeve.

Janë kërkuar **suvatues/murator**, të cilet janë të nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve për suva, muret etj. sipas zërave të preventivit të punimeve.

Janë kërkuar **pllakashtrues**, të cilet janë të nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e veshjeve me pllake të shtresave etj., sipas zërave të preventivit të punimeve.

Janë kërkuar **bojaxhi**, të cilet janë të nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve të bojatisjes, sipas zërave të preventivit të punimeve.

Janë kërkuar **hidroizolues**, të cilet janë të nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve të hidroizolimit etj., sipas zërave të preventivit të punimeve.

Janë kërkuar **punonjes gipsi**, të cilet janë të nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve të gipsit etj., sipas zërave të preventivit të punimeve.

Janë kërkuar **punonjes fasade**, të cilet janë të nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve të fasades etj., sipas zërave të preventivit të punimeve.

Janë kërkuar **saldator**, të cilet janë të nevojshëm për realizimin e punimeve të saldimit, sipas zërave të preventivit të punimeve.

Janë kërkuar **specialist dur alumini**, të cilet janë të nevojshëm për realizimin e punimeve të dritareve dhe dyerve dur alumini, sipas zërave të preventivit të punimeve.

Janë kërkuar **specialist kondicionimi**, të cilet janë të nevojshem për realizimin e punimeve të kondicionimit, sipas zërave të preventivit të punimeve.

Janë kërkuar **specialist IT**, të cilet janë të nevojshem për realizimin e punimeve të IT etj., sipas zërave të preventivit të punimeve.

Janë kërkuar **marangoz**, të cilet janë të nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e punimeve të drurit, sipas zërave të preventivit të punimeve.

Janë kërkuar **shofer**, të cilet janë të nevojshem për drejtimin e mjeteve të nevojshme gjatë realizimit të punimeve të objektit.

Janë kërkuar **manovrator / automakinist**, të cilet janë të nevojshem për drejtimin e mjeteve të renda te nevojshme gjatë realizimit të punimeve të objektit.

2.3.6 Operatoret Ekonomike duhet të kenë në stafin teknik ose mbështetes, të çertifikuar të pakten:

2.3.6/a -1 (nje) punonjes të pajisur me çertifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327, datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Për të përmbushur këtë kriter OE duhet të paraqese kontrate pune, certifikaten përkatëse si dhe duhet të jetë në listëpagesat e shoqërisë të paktën për periudhën **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave.

2.3.6/b -1 (nje) Punonjes i pajisur me çertifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Per te përmbushur kete kriter OE duhet te paraqese kontrate pune, certifikaten perkatese si dhe duhet të jetë në listëpagesat e shoqërisë të paktën për periudhën **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave.

2.3.6/c -3 (tre) punonjes të trajnuar për punime në lartësi të cilet të jenë të pajisur me certefikate “Për punime në lartësi”. Për të përmbushur këtë kriter OE duhet të paraqese kontrate pune dhe certifikaten përkatëse ose deshmi nga institucione të akredituara si dhe duhet të jetë në listëpagesat e shoqërisë të paktën për periudhën **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave.

Shenim: Kjo kërkesë përmbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit permbledhes të vetedeklarimit sipas shtojces përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari, perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimit.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ligjin nr. 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar dhe me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e

sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjes së shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Njesia e Prokurimit mban në konsideratë se shkolla 9 vjeçare është një objekt relativisht i lartë dhe punonjësit do të punojnë në shkallë të lartë, kështu që operatorët ekonomikë të disponojnë punonjës të trajnuar për punime në lartësi me qëllim shmangien e aksidenteve në punë.

2.3.7 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund të vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës) konkretisht:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 10 ton	Në pronësi ose me qera	Cope	3
2	Kamion me Vinc min 5 ton	Në pronësi ose me qera	Cope	1
3	Autovinç me Kosh	Në pronësi ose me qera	Cope	1
4	Kamionçina me kapacitet mbajtës 3.5 - 5 ton	Në pronësi ose me qera	Cope	2
5	Autobetoniere	Në pronësi ose me qera	Cope	1
6	Autopompe betoni	Në pronësi ose me qera	Cope	1
7	Eskavator me goma (mjet teknologjik me goma)	Në pronësi ose me qera	Cope	2
8	Fadrome me goma (mjet teknologjik me goma)	Në pronësi ose me qera	Cope	1
9	Skeleri dhe rrjete rrethimi	Në pronësi ose me qera	m2	1500
10	Saldatriçe	Në pronësi ose me qera	Cope	1
11	Matrapik	Në pronësi ose me qera	Cope	3
12	Vibrator	Në pronësi ose me qera	Cope	2
13	Betoniere kantieri	Në pronësi ose me qera	Cope	1
14	Pompe Suvatimi	Në pronësi ose me qera	Cope	2
15	Rimorkiator	Në pronësi ose me qera	Cope	1
16	Gjenerator	Në pronësi ose me qera	Cope	2
17	Zyre Kantieri	Në pronësi ose me qera	Cope	1
18	Depozite uji (kapaciteti minimal 1000 litra)	Në pronësi ose me qera	Cope	1
19	Gazogjen	Në pronësi ose me qera	Cope	1
20	Elektroorgano	Në pronësi ose me qera	Cope	1

Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 "Për miratimin e Rregullores për Sigurinë në Kantier", si më poshtë vijon:

- Kokore minimumi 50 cope
- Fikëse zjarri të lëvizshme minimumi 5 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 3 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë

Për të dëshmuar këtë, Formulari i shtojcës të DST duhet të shoqërohet me dokumentat e mëposhtme:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërtetojnë pronësinë e mjetit: - certifikatën e pronësisë; -leja e qarkullimit; -certifikatën e kontrollit teknik; - sigurancën; - taksat vjetore; - leja e transportit, si dhe të paraqesë foto të qarte për secilin mjet dhe të jetë e dukshme targa e mjetit.
- Ndërsa për mjete të marra me qera krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerave e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore përkatëse, ndërsa për mjete të marra me qera, krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerave.

Shenim: Kjo kërkesë përmbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatëve të ankimit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet dhe pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronësi/qera ose kontrate bashkëpunimi janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. Sasia e mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

Njesia e prokurimit thekson se mjetet e transportit nevojiten për transportimin e materialeve të ndërtimit.

Ndërsa mjetet e germimit nevojiten për germimin e themeleve dhe sistemin e ambienteve gjatë punimeve për rikonstruksionin e shkolles.

Mjeti autovinc është kërkuar për realizimin e transportit dhe të ngritjes së bazës materialeve, meqëse punohet edhe në lartësi.

Është kërkuar autobetoniere, autopompe betoni për realizimin e punimeve të betonit.

Është kërkuar skeleri dhe rrjete për rrethimin e objektit me skeleri dhe rrjete mbrojtëse.

Është kërkuar fadrome dhe eskavator për realizimin e punimeve të germimit dhe sistemit.

Eshte kerkuar pompe suvatimi per realizimin e punimeve per suvatimin e objektit.
Eshte kerkuar matrapik per realizimin e punimeve te prishjes.
Eshte kerkuar saldatrice per realizimin e konstruksioneve metalike etj.
Eshte kerkuar rimorkiator per realizimin e transportit te mjeteve te renda dhe baze materiale.
Eshte kerkuar zyre kantieri pasi eshte e nevojshme gjate realizimit te punimeve nje ambient i pershtatshem per mbajtjen e dokumentacionit teknik etj.
Eshte kerkuar gazogjen, elektroorgano per realizimin e punimeve te posacme te ndertimit.
Eshte kerkuar gjenerator per te bere te mundur venien ne funksion te pajisjeve te ndertimit.
Eshte kerkuar depo uji per mbajtjen e rezervave te ujit, per tu perdorur gjate realizimit te punimeve.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i paisur me:

- Licence e leshuar nga Qendra Kombetare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte”.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku parashikohet se Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Ky kriter eshte vendosur bazuar në Ligjin nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, bazuar në Nenin 5 “Mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe mjedisit”, në Ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, si dhe referuar raportit të vleresimit të ndikimit në mjedis, raportit teknik dhe Specifikimeve teknike të projektit objekt prokurimi dhe kompleksitetit të kontratës, metodat e punës që duhet të aplikohen nga zbatuesi duhet të synojnë në minimizimin ose nëse eshte e mundur në ndalimin e cenimeve ndaj mjedisit dhe duhet të tregojë një kujdes maksimal në transportin e materialeve me qëllim mbrojtjen maksimale të mjedisit.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi ose qira ose furnizimi si më poshtë vijon:

1 (një) Impiant prodhimi Betoni e vendosur jo më larg se 40 km nga objekti.

Për impiantin e prodhimit të betonit, në rast se është në pronësi duhet të jenë të pajisur me Akt-Miratimin dhe leje mjedisore QKL Kodi III.1.B. Në rast se impianti i prodhimit të betonit, është me qera ose furnizimi duhet të paraqitet kontrata e qerave / furnizimit, e shoqëruar me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B.

Për impiantin e prodhimit të betonit, në rast se eshte në pronësi duhet të jenë të pajisur me Akt-Miratimin dhe leje mjedisore QKL Kodi III.1.B. Në rast se impianti i prodhimit të betonit, eshte me qera ose kontrate bashkepunimi duhet të paraqitet kontrata e qerave/furnizimit. (KVO do të verifikojë nepermjet QKB nëse impianti i prodhimit të betonit eshte i pajisur me license III.1.B, në rast të kundërt OE do të skualifikohet).

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku parashikohet se Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në

varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Autoriteti Kontraktues referuar zerave objekt i kontrates qe po prokurohet ka kerkuar qe impianti i prodhimit te betonit mund te jene ne pronesi, me qera ose me kontrate furnizimi qe do te shpallet fitues si nje garanci teknike qe kontrata do te realizohet brenda afateve dhe ne te gjithë kompleksitetin e zerave te punimeve

Po ashtu theksojme se Autoriteti Kontraktor nuk kerkon asnje dokumentacion nga subjekte te treta, pasi verifikimi nese impianti i prodhimit te betonit eshte i pajisur me license III.1.B sipas kërkesave ligjore per mbrojtjen e mjedisit, do te behet nepermjet QKB-se ne web www.qkb.gov.al.

2.3.10 Operatori ekonomik në rast se nuk është prodhues duhet të paraqese kontrate furnizimi për materialet si me poshtë:

- Bojrat dhe Gipsin
- Materialet e termoizolimit, hidroizoluese
- Materialet Elektrike
- Materialet Hidraulike
- Makineri dhe Pajisjet e Kondicionimit

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose çdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar. Për materialet / pajisjet sa me sipër, Operatori ekonomik duhet te paraqese kataloge, skedat teknike, deshmi te testimeve zyrtare, certifikate iso 9001 per prodhuesin. I gjithë dokumentacioni i paraqitur duhet të jetë në gjuhen shqipe.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku parashikohet se Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriterë të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Ky kriter vendoset bazuar ne zerat e preventivit te punimeve qe do te realizohen dhe rendesise se vecante te objektit te prokurimit, duke marre ne konsiderate se godina eshte nje objekt civil qe shfrytëzohet nga nxenesit e shkolles.

Meqenese punimet do te kryhen ne nje objekt qe kerkon kujdes te vecante per shkak te frekuentimit nga nxenesit e shkolles shfaqet e nevojshme qe per mallrat qe do te perdoren ne realizimin e punimeve, Autoriteti Kontraktor te garantohet qe keto mallra furnizohen nga prodhues apo distributor te autorizuar dhe ne cilesine duhur.

2.3.11 Operatori ekonomik duhet të dorëzojë autorizim prodhuesi / distributori të autorizuar, katalog/fragment katalogu/ skede teknike, për mallrat e mëposhtem:

Nr	Emertimi i Mallit
1	Kaldaje çeliku
2	Element radiatorit alumin
3	Tub Cu te perkulshem me termoizolim
4	Instalimet e sistemit te ajerit per ventilimin dhe rrjeti i shperndarjes se tubave
5	Dritare plastike

Katalogu/fragment katalogu/ skede teknike duhet të markohet në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secili nga artikujt e mesipër sipas modelit të deklaruar dhe të shenohen për të gjithë artikujt e mesipërme. Për materialet / pajisjet sa me sipër, Operatori ekonomik duhet të paraqesë kataloge, skedat teknike, deshmi të testimave zyrtarë, certifikate ISO 9001 për prodhuesin. I gjithë dokumentacioni i paraqitur duhet të jetë në gjuhën shqipe.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku parashikohet se Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Njesia e Prokurimit mban në konsideratë se këto pajisje kanë vlerë relativisht të lartë dhe lidhet me funksionimin e shkolles dhe ndikojnë në lëvizshmërinë e fëmijëve nëpër kate dhe ngrohje ftohjen e objektit.

2.3.12 Operatorët Ekonomikë ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO të leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- **ISO 9001:2015**, mbi “Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalentin e saj
- **ISO 45001:2015**, mbi “Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe sigurisë në punë”, ose ekuivalentin e saj.
- **ISO 14001:2015**, mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalentin e saj.

Certifikatat e paraqitura duhet të jenë të vlefshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Referuar natyrës së veçantë, vendndodhjes dhe përmasave të objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë, sigurisë në punë dhe mjedisit. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

2.3.13 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratën ku të shprehet se është dakort me mënyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

Paraqitja e kësaj deklarate është kërkuar, pasi financimi është parashikuar në buxhetin 2025-2027, por afati i realizimit është sipas grafikut të punimeve.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku parashikohet se Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Njesia e prokurimit thekson se financimi i këtij objekti është kryer në bashkepunim me Ministrinë e Arsimit dhe është i shtrirë në vitet buxhetore 2025-2027.

Shenim: Për çdo emertim marke apo cilësie të shënuar në preventivin e punimeve do të pranohet edhe ekuivalenti i tij.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:

Njesia përgjegjëse ka hartuar/konfirmuar specifikimet teknike, ku janë shprehur qartë kërkesat AK për realizimin e kontratës.

Njesia përgjegjëse në specifikimet teknike argumenton se nuk ka përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

NJËSIA E PROKURIMIT: